



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 41, datë 06.10.2017

PËR LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS GRAMSH

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" si dhe VKM nr. 958, date 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Sh.a Ujësjiellës Gramsh me:
Drejtues Ligjor Tajar Bici
Drejtues Teknik Miranda Bici
2. Operatori Sh.a Ujësjiellës Gramsh autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është:

Bashkia Gramsh
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 34, datë 10.07.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 41, DATË 06.10.2017, "PËR LICENCIMIN E SH.A. UJËSJELLËS GRAMSH", I
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 10.07.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 06.10.2017, "Për licencimin e sh.a. Ujës-jellës Gramsh", i ndryshuar,

Vëren se:

1. Shoqëria Ujës-jellës Gramsh (**U Gramsh**) me shkresën nr. 445 prot. datë 28.05.2019, me lëndë "Përcjellje e dokumenteve të nevojshëm për ndryshimin e drejtuesit teknik" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së U Gramsh për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR ka licencuar shoqërinë U Gramsh me vendimin nr. 41, datë 06.10.2017, “Për licencimin e sh. a. Ujësjetllës Gramsh”, i ndryshuar me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik.
4. Drejtuesi teknik i shoqërisë U Gramsh sh.a. z. Bledjan Koçi zotëron diplomë master shkencor në Inxhinieri Hidroteknike marrë në nëntor 2017.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e U Gramsh sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficientë, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i U Gramsh është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR nr. 41, datë 06.10.2017 "Për licencimin e sh.a Ujësjetllës Gramsh", i ndryshuar bëhen këto ndryshime:
“Drejtues Teknik z. Bledjan Koçi”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI